

Autostrada Biennale me kënaqësi ju njofton me artistët e saj, idetë, hapësirat dhe datat e edicionit të tretë

Çka nëse një rrugëtim...

Kuruar nga Övül Ö. Durmuşođlu dhe Joanna Warsza

Prishtina: 1 korrik – 11 Shtator, 2021

Agnes Denes; Petrit Halilaj & Alvaro Urbano

Prizren: 17 korrik – 11 Shtator, 2021

Agnes Denes, Alban Muja, Agnieszka Polska; Agron Blakçori, Banu Cennetođlu, Bora Baboçi, Camila Rocha, Cooking Sections & Fejsal Demiraj, Doruntina Kastrati, Edona Kryeziu, Fernando García-Dory, Flaka Haliti, Gülsün Karamustafa, HAVEIT, Hera Büyüктаşçıyan, Iman Issa, Iramamama, Małgorzata Mirga-Tas & Edis Galushi, Marwa Arsanios, Núria Güell & Lumnije Gërguri Stojkaj, Rossella Biscotti, Sezgin Boynik & Tevfik Rada, Ulf Aminde & Manuel Gogol, Vahida Ramujkić, Valbona Zherka

Peja: 19 korrik – 11 shtator, 2021

Ex-EXIT me Agush Beqiri, Hüseyin Bahri Alptekin

Çka nëse një rrugëtim... është një ekspozitë për të papërfunduarën. Mund të jetë një rrugë, një hartë elektrifikimi, një shtëpi, një fushë me lule, një tregim, një marrëdhënie ose një shtet. Është ekspozitë që paplotësinë e merr si ftesë për t'u përgjigjur, për t'u lidhur dhe për t'u rritur.

Çka nëse një rrugëtim... është ekspozitë për dy skajet e një rruge që takohen ndërmjet mikpritësit e të ftuarit, të mërguarës e vendores, ndërmjet infrastrukturës dhe intimitetit.

Çka nëse një rrugëtim... është poashtu ekspozitë për artin si formë e rikuperimit nga kurthet e përditshmërisë. Të merr me vete e të shpie në një rrugëtim, duke filluar nga qendra e Prishtinës, e përgjatë rrjedhës së Lumbardhit në Prizren, për të përfunduar në një bar arti në Pejë.

“Në udhëtimin tonë të parë kërkimor në Prizren, në vjeshtën e vitit 2020, ne dëgjuam histori që nevojiteshin të dëgjoheshin: nga artistë, organizatorë, etnologë të ushqimit, një aktivist rom, një mbrojtës i trashëgimisë, një sociolog urban dhe një filozof, ndër shumë të tjerë. Ekspozita është përgjigja jonë ndaj atyre historive. Grumbulli i endur i rrugëve të mbivendosura të artistes Valbona Zherka, na ofroi një hartë orientimi të përbërë nga rrjedhat e lumenjve, rrugët e arratisjes, shtigjet e migrimit, parregullsitë pozitive, kthesat në formë U, mënyrat e papitura të nisjes dhe mbërritjes. Edicioni i 3-të Autostrada Biennale është ftesë për një rrugëtim të papërfunduar, brenda dhe jashtë Kosovës - për në Berlin, Stamboll, Varshavë dhe prapa. Ose diku ndërmjet.”— Övül Ö. Durmuşođlu dhe Joanna Warsza

Autostrada Biennale është krijuar nga dy artistë dhe një pedagog në vitin 2014. Si institucioni i vetëm i artit bashkëkohor në Prizren funksionon me dy shpejtësi, njëra është ekspozita fizike që ndodh çdo dy

vite në hapësirën publike dhe e dyta plani ynë afatgjatë për të krijuar qendrën edukative në ish bazën ushtarake të KFORIT, ku procesi i përgatitjes së ekspozitës është i hapur për publikun, duke e bërë krijimin e veprave artistike një formë të të mësuarit dhe të menduarit kritik.

Autostrada Bienale është bërë e mundur me mbështetjen bujare dhe partneritetin e Zyra Zvicrane për Bashkëpunim në Kosovë, Komuna e Prishtinës, European Cultural Foundation, Foundation of Art Initiatives, Komuna e Prizrenit, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Manifesta 14 Prishtina, United Nations Kosovo Team, UNDP, KFOS, Raiffeisen Bank, Goethe Zentrum Prishtina, SAHA Foundation, Italian Institute for Culture in Tirana, Qendra Regjionale për Trashëgimi Kulturor në Prizren, Biblioteka Kombëtare, Museum of Modern Art in Warsaw, Institut Ramon Llull, Stacioni i Autobusave në Prizren, Instituti Arkeologjik i Kosovës, Friedrich Ebert Stiftung, JYSK, ITP Prizren, DokuFest, Fondacioni Lumbardhi, Anibar, Pallati i Rinisë dhe Sportit në Prishtinë, Edicioni i 5'te i Javes se Krenarise, MAM Foundation, Kultplus, Mor Charpentier, Galerist, Wilfried Lentz, ChertLüdde.

Autostrada Biennale hapësira për edukim dhe prodhim u mbështet nga Ambasada Amerikane në Prishtinë, Komuna e Prizrenit, Gjirafa50, dhe Kreativ Qeramika.

Autostrada Biennale është mirënjohëse për mbështetjen bujare të partnerëve të shumtë individual për punën dhe bashkëbisedimet në Prishtinë, Prizren dhe Pejë, të cilët e bënë të mundur realizimin e këtij edicioni.